



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E
SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE
MEDIUMET ELEKTRONIKE***

29 Dhjetor 2015



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Javën e kaluar gjithsej 1.164 thirrje në Alo doktor!



Javën e kaluar, përfundimisht me sot në mëngjes, 1.164 persona kanë kërkuar këshilla mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor".

Siç njoftoi ESHP Shtëpia e Shëndetit Shkup, të gjithë personave të cilët janë paraqitur në Alo doktor! u është dhënë ndihmë mjekësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatologjike.

Prej 15.09.2014 në 02/15 123 prej kur ka filluar të punojë linja telefonike Alo doktor! janë regjistruar gjithsej 68.378 thirrje.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtpërdrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të çrregullimit shëndetësor, ndërsa të qasshëm janë 25 mjekë për këshilla mjekësore.



Javën e kaluar gjithsej 1.164 thirrje në Alo doktor!



mjekë për këshilla mjekësore.

Siç njoftoi ESHP Shtëpia e Shëndetit Shkup, të gjithë personave të cilët janë paraqitur në Alo doktor! u është dhënë ndihmë mjekësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatologjike.

Prej 15.09.2014 në 02/15 123 prej kur ka filluar të punojë linja telefonike Alo doktor! janë regjistruar gjithsej 68.378 thirrje.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtpërdrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të çrregullimit shëndetësor, ndërsa të qasshëm janë 25



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Maskat kirurgjike nuk mbrojnë prej grimcave PM10

Shkup, 28 dhjetor - Maskat kirurgjike nuk mbrojnë prej grimcave PM10, ndërsa rekomandimet që i solli qeveria, nuk mundet plotësisht ta ulin nivelin e ndotjes së ajrit në Shkup dhe Tetovë, thonë ekspertët e shëndetësisë. Sipas mjekut Dragan Gjorgjov nga Fondi republikan i mbrojtjes shëndetësore, grimcat PM10 ndikojnë në mënyrë afatgjatë mbi shëndetin e njerëzve.

"Nëse një kohë të gjatë i ekspozoheni ajrit të ndotur, siç i jemi ekspozuar ne në Shkup për dekada, atëherë, rezistenca e njerëzve që jetojnë në atë rajon, dobësohet. Një pjesë e atyre efekteve nuk janë të dukshme, por me kalimin e viteve, për shkak të dobësimit të sistemit imunitar, ato ngadalë fillojnë të duken, dhe ato njerëz, që janë relativisht të sëmurë, hyjnë në kategorinë e të sëmurëve dhe në fund, ato që kanë komplikime më të rënda, përfundojnë me vdekje", tha Dragan Gjorgjov nga Fondi Republikan i Mbrojtjes Shëndetësore.

Sipas tij, gratë shtatzëna nëse dëshirojnë të mbrohen mirë, duhet të përdorin maskë, e cila pengon 97% të grimcave, sepse maskat kirurgjike fare nuk mbrojnë.

"Gratë shtatzëna kanë përgjegjësi të madhe, jo vetëm për shëndetin e tyre, por edhe për shëndetin e frytit, për shkak se ai mund t'u ekspozohet materialeve toksike. Është e njëjta gjë, kur ne rekomandojmë të mos lëvizet nëpër hapësira ku pihet duhan, sepse efektet negative janë të ngjashme", shtoi Gjorgjov.

Sipas tij, koncentrimi e grimcave të dëmshme është tejet i madh dhe, edhe në qoftë se ndalet i gjithë trafiku, emisioni do të pakësohet vetëm për 15-20 %, gjë që nuk mjafton. Ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov, sot nuk dëshiroi të japë deklaratë për mënyrën se si qytetarët të mbrohen nga ndotja. Ai i përmendi vetëm masat, të cilat i miratoi dje qeveria.

"Kemi rekomandime të aspektit shëndetësor, të cilat i publikoi dje qeveria. Pjesa më e madhe e tyre kishin aspekt shëndetësor", tha Todorov.

Qytetarët, për shkak të ndotjes, gjithnjë e më shpesh mbajnë maska dhe shalle, ndërsa gratë shtatzëna më rrallë dalin nga shtëpitë.

"Unë kam edhe problem shëndetësor dhe e ndjej se ajri është vërtet i ndotur. Mendoj se do të dukesh çuditshëm, nëse do të mbaja maskë".

"Nuk dalim. Më së shumtë qëndrojmë në shtëpi. Kur na duhet të shkojmë diku, shkojmë me veturë. Jetojmë në Përzhinë, e ajri atje është pak më i pastër", shprehen qytetarët.

Sipas ekspertëve shëndetësore, gjendja me ajrin e ndotur, aq është alarmante, sa që qytetarët duhet të fillojnë të mendojnë edhe për instalimin e pastruesve të ajrit nëpër shtëpitë e tyre, sepse ndotja është gjithkund, ndërsa nëpër shtëpitë, është vetëm 30% më pak sesa jashtë.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Gostivari bën rekorde, 900 foshnje për një vit

Shkup, 28 dhjetor – Në Maqedoni sidomos në komunat ku dominojn shqiptarët ka rritje rekorde të foshnjeve të lindura. Bëhet fjalë për komunën e Gostivarit, ku vetëm për një vit lindin 900 foshnje, por 200 foshnje tjera lindin jashtë këti qyteti por prindërit janë nga Gostivari.

Kështu flasin të dhënat e spitalit të Gostivarit, konkretisht të repartit të gjinekologjisë. Të dhënat e këti spitali flasin se në Gostivarë për herë të fundit një grua lindi 3 fëmijë para 10 viteve, ndërsa bineqët janë raste të shpeshta. Për dallim nga Gostivari në Komunat ku dominojn maqedonasit lindja e foshnjave është minimale, për këtë shkak sipas entit shtetërorë për statistik numri i foshnjave në nivel republikan është zvogluar për 3%.



Tetova 'rekordere', kalon maksimumin e ndotjes mbi 1000 mg PM10



Mbrëmë në Tetovë është shënuar rekordi më i ri dhe maksimal i ndotjes së ajrit. Grafikoni në ueb faqen e ministrisë së ambientit preki maksimumin e 1000 mikrogram PM10 për metër kub. Ndërkaq softueri që tregon shifrat e sakta të ndotjes kur ju afua këtij niveli u bllokua, pasi nuk kalon numrat treshifror.

Çdoherë që koncentrimi i grimcave PM 10 kalon normën prej 50 mikrogramëve për metër kub, llogaritet se ajri është i ndotur, ndërkohë që Në Tetovë, ndotja ka tejkaluar 20-fishin e normës së lejuar.

Filluan protestat për ajër të pastër para qeverisë (Foto)



Rreth dy mijë qytetarë janë grumbulluar para qeverisë së Maqedonië për të protestuar kundër ndotjes alarmante të ajrit. Tetova dhe Shkupi tani gjatë kohë gjenden në majë të listës së qyteteve më të ndotura në



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



botë, kurse autoritetet refuzojnë të ndërmarrin masa konkrete edhe përkundër protestave të vazhdueshme të qytetarëve. Në protestën e sotme marrin pjesë edhe shumë qytetarë nga Tetova.



Javën e kaluar gjithsej 1.164 thirrje në Alo doktor!



Javën e kaluar, përfundimisht me sot në mëngjes, 1.164 persona kanë kërkuar këshilla mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor"...

Siç njoftoi ESHP Shtëpia e Shëndetit Shkup, të gjithë personave të cilët janë paraqitur në Alo doktor! u është dhënë ndihmë mjekësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatologjike.

Prej 15.09.2014 në 02/15 123 prej kur ka filluar të punojë linja telefonike Alo doktor! janë regjistruar gjithsej 68.378 thirrje.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtpërdrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të çrregullimit shëndetësor, ndërsa të qasshëm janë 25 mjekë për këshilla mjekësore. (mia.mk)

Mjetet piroteknike, të rrezikshme dhe i kontribuojnë ndotjes



Megjithëse këtyre ditëve është folur shumë për nivelin e lartë të ndotjes, nuk ka munguar edhe aroma e barotit...

Megjithëse këtyre ditëve është folur shumë për nivelin e lartë të ndotjes, nuk ka munguar edhe aroma e barotit, që si rëndom kur ofrohen festat e fundvitit është e pranishme nga shpërthimi i mjeteve piroteknike.

Edhe pse ato paraqesin rrezik sidomos për fëmijët, përsëri ata vazhdojnë të shpërthejnë fishekzjarre dhe pushkaliqe.

Qytetarët e anketuar nga TVM2 shprehen të shqetësuar dhe thonë se mjetet piroteknike janë të dëmshme dhe nuk kalohet nga tregu i gjelbër prej pëlcitjeve të shumta, e sidomos prej aromës së keqe që shpërndahet.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



“Do t’i lëndojnë duart, shumë veta kanë marrë, por ua kanë parë sherrin. Prindërit i kanë fajet më shumë, nuk duhet t’u blejnë, sepse ata janë fëmijë kanë dëshirë. Prej erës nuk kalohet këtu”- deklaroi një qytetar.

“Na pengojnë shumë, sidomos ne në treg që punojmë, edhe kaluesve edhe ata që blejnë. Të dëmshme janë, të dobishme janë për ata që i shesin”- tha një qytetar.

“Unë mendoj se nuk duhet të festohet në atë mënyrë, sepse mund të ketë edhe pasoja më të rënda. Mendoj se duhet të merren disa masa adekuate për festimin e Vitit të Ri në mënyra të ndryshme”- theksoi një qytetar.

“Mendimi im është të ndalohen në çdo aspekt, rrezikojnë jetën e të rinjve, sidomos të fëmijëve”- u shpreh një qytetar.

Nga Sektori për Punë të Brendshme në Shkup apelojnë që qytetarët t’i shmangen përdorimit të mjeteve piroteknike, të cilat në shumë raste përfundojnë me pasoja fatale për vetë përdoruesit.

Kryqi i Kuq dhe EVN, së bashku në aksion humanitar “Të shpërndajmë gëzim” për fëmijët me nevoja të veçanta



Babagyshi këtë vit nuk i harroi edhe fëmijët me nevoja të veçanta. Në kuadër të aksionit humanitar “Të shpërndajmë gëzim”...

Babagyshi këtë vit nuk i harroi edhe fëmijët me nevoja të veçanta. Në kuadër të aksionit humanitar “Të shpërndajmë gëzim”, të organizuar nga Kryqi i Kuq i Maqedonisë dhe EVN, u ndanë 130 pako me dhurata për fëmijët me probleme edukativo-sociale, si dhe ata të cilët rrjedhin nga familje që përballen me vështirësi ekonomike.

Ky është viti i pestë me radhë që Kryqi i Kuq i Maqedonisë, me mbështetjen e EVN-së, organizon ngjarje për të njëjtin qëllim dhe se kjo traditë do të vazhdojë, tha me këtë rast sekretari gjeneral i Kryqit të Kuq, Sait Saiti.

“Kjo është një dëshmi tjetër që Kryqi i Kuq përkujdeset për ata të cilët nuk kanë mundësi t’i plotësojnë nevojat e tyre. Në fund të vitit çdonjëri nga ne dëshiron të shpërblehet me ndonjë dhuratë dhe ne sot së bashku u munduam që këtyre fëmijëve për një çast t’ia zbukurojmë ditën”- deklaroi sekretari gjeneral i Kryqit të Kuq, Sait Saiti.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Nga EVN-Maqedoni shprehen se është ndjenjë e veçantë t'i mundësohet atyre që kanë nevojë, në veçanti fëmijëve, të ndjejnë simbolikën dhe magjinë e festave të fundvitit.

“Përgjegjësia e EVN-së si dhe e kompanive të tjera në vend ndaj shoqërisë është që t'i ndihmohet këtyre fëmijëve, me qëllim që të kenë ditë më të mira, të mbushura me gëzime, të qeshura dhe dhurata. Partneriteti me Kryqin e Kuq do të vazhdojë, me qëllim që të shpërndajmë sa më shumë lumturi për këtë kategori të ndjeshme të shoqërisë tonë”- tha Igor Gievski nga EVN-Maqedoni.

Në ngjarjen e organizuar në hapësirën e Kinotekës së Maqedonisë fëmijët kishin mundësinë të ndjekin edhe një projekt kinematografik të një filmi vizatimor 3D, të mundësuar nga “Megakom”.

Qeveria: Gratë shtatzëna të lirohen nga puna; qytetarët: Ndotja e ajrit ju pengon të gjithëve

Lirimi nga puna i kategorive të rrezikuara, siç janë gratë shtatzëna, për shkak të nivelit të lartë të ndotjes, është një vendim i duhur, thonë gjinekologët...



Ata rekomandojnë që gratë shtatzëna të izoloohen në shtëpi, sepse në këtë kohë me smog ekziston mundësia e paraqitjes së anomalive të lidhura në embrionin.

“Gratë shtatzëna në fillim të muajve të para të shtatzënisë, atëherë edhe kur formohet fryti, mos të ekspozohen, të kenë kujdes më të madh, mos të dalin, mos të shëtisin në këtë kohë, në këtë situatë që po ndodhë aktualisht në Shkup. Nëse i ekspozohen këtyre, kësaj që po i ndodh me smogun Shkupit, ekziston mundësia që të vijë deri te paraqitja e anomalive të lidhura në embrion dhe prandaj këtyre grave u rekomandohet të izoloohen në shtëpi. Por, edhe ato gratë të cilat janë shtatzëna, në muajt më të avancuar të shtatzënisë edhe ato bartin rreziqe ndaj frytit nëse ekspozohen ndaj këtyre ndotësve”- deklaroi gjinekologu, Alfred Purine.

Ndërsa qytetarët shprehen se ndotja e ajrit po shkakton pasoja në shëndetin e tyre e sidomos te fëmijët dhe të moshuarit.

“Duhet të ndërmerren masa për parandalimin e pasojave më të mëdha”- tha një qytetar.

“Të gjithëve ju pengon jo vetëm mua edhe fëmijët janë të sëmurë, hiq nuk bën puna”- theksoi një qytetar.

“Shumë, tepër, jo vetëm në shëndetin tim, por në përgjithësi, në shëndetin e banorëve apo qytetarëve si fëmijëve dhe pleqve”- u shpreh një qytetar.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Ndryshe, në një seancë të jashtëzakonshme të qeverisë, mbrëmë për shkak të problemeve me ajrin e ndotur është marrë vendim që gratë shtatzëna dhe personat e sëmurë kronikë të lirohen nga puna.

Ndërsa në Tetovë, Shkup, Manastir, Kërçovë dhe Koçan edhe sot janë regjistruar koncentrimet të larta të grimcave PM10. Sipas matjeve të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, sot në mëngjes koncentrimet prej 373 mikrogramëve në metër katror janë regjistruar në Tetovë, 337 në Qendër, Gazi Babë 190, Lisiçe 258, Manastir 213, Karposh 227, Kërçovë 133 dhe Koçan 109.

Gjinekologjia mori donacion prej njëqind jastëqeve për gra shtatzëna dhe lehona



Njëqind jastëqe special anatom për gra shtatzëna dhe lehona do të marrë sot donacion Klinika për gjinekologji dhe akusher...

Bëhet fjalë për donacion me vlerë prej 200.000 denarë të mbledhura në simpoziumin edukativ humanitar me temë "Metodat dhe teknikat stomatologjike bashkëkohore", që e organizoi Oda stomatologjike e Maqedonisë me rastin e 20-të vjetorit të ekzistimit të saj.

Nënkryetarja e Odës stomatologjike të Maqedonisë, Marija Andonovska pas ndarjes së donacionit theksoi se do të vazhdojnë të punojnë për përparimin e veprimtarisë stomatologjike dhe të përkujdesen për aktivitetet e karakterit humanitar.

Drejtoresha e Klinikës për gjinekologji dhe akusher, Marija Haxhi Lega u falënderua për donacionin dhe potencoi se jastëkët do t'u ndihmojnë shtatzënave të ardhshme shumë më lehtë ta kalojnë edhe periudhën pas lindjes, si dhe periudhën gjatë hospitalizimit në repartet për shtatzëni patologjike dhe për kujdesje intensive peripartum dhe në atë mënyrë t'u mundësojnë qëndrim më të lehtë në Klinikë. (mia.mk)

PORTALB
dritare realiteti

Tetova dhe Shkupi më të ndotur



Ajri sot në mëngjes është më i ndotur në Tetovë dhe në Shkup. Koncentrimet të larta të grimcave PM 10 në ajër ka edhe në Manastir dhe Kërçovë. Stacionet matëse në Tetovë regjistruan koncentrim të grimcave PM1 prej 386 mikrogramëve në metër kub. Në Shkup, koncentrimet më të larta ka në Qendër, prej 332 mikrogramëve, Gazi Babë 310, afër Rektoratit 279, Lisiçe 264, Karposh 252 dhe Milladinovci 96. Në Manastir janë matur 118, ndërsa në Kërçovë 115 mikrogramë. Mbi koncentrimet e lejuara të grimcave PM10 sot në mëngjes janë regjistruar edhe në Kavadar me 61, Veles 57 dhe Koçan 55 mikrogramë, [raporton MIA](#).



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Qeveria dje për shkak të ndotjes solli konkludime dhe rekomandime të cilat kanë të bëjnë me komunat ku janë të larta koncentrimet. Sipas rekomandimeve duhet të lirohen nga obligimet e punës gratë shtatzëna, personat mbi moshën 60 vjeçare me sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe personat nën moshën 60 vjeçare me diagnozë të astmës dhe sëmundjes kronike obstruktive të mushkërive të bardha (SKOM), deri më 4 janar. Të intensifikohen aktivitetet për pastrimin e rrugëve, veçanërisht rreth fushëndërtimeve.

Inspektorati shtetëror i mjedisit jetësor, deri më 4 janar të vitit 2016 të bëjë kontroll të jashtëzakonshëm të përditshëm në instalimet të cilat u nënshtrohen lejes së integruar ekologjike A. Njëherë në javë të bëhet kontroll i instalacioneve të cilat u nënshtrohen lejes së integruar ekologjike B vetëm në pjesën e emisioneve në ajër dhe imisioneve. Si dhe të jepet rekomandimi për punë të reduktuar të kapaciteteve industriale në njësinë adekuate të vetëqeverisjes lokale.

Ndër rekomandimet për qytetarët janë që më shpesh ta shfrytëzojnë transportin publik, të mos i shfrytëzojnë automjetet pa nevojë të madhe, ta racionalizojnë përdorimin e automobilave që nënkupton, më shumë persona të voziten me një automjet në të njëjtën kohë dhe të respektohen dispozitat ligjore, në pikëpamje që të mos shfrytëzohet për ngrohje të hapësirave vaj i djegur i mbeturinave, mbeturina të ngjyrosura nga druri dhe mobiljet, stiropor, PET ambalazhat, pjesë të gomave dhe çfarëdo lloj materiali sintetik. Siç thuhet në kumtesën e pres shërbimit qeveritar, Qeveria e obligoi Inspektoratin shtetëror për mjedis jetësor të bëjë kontrolle në të gjitha autoserviset dhe përderisa konstaton parregullsi gjatë punës në kompetencë e tyre, të ndër marrë masa adekuate. Për shkak të ndotjes së ajrit nën moton “Dil për ajër” u mbajt protestë e inicuar nga dhjetëra shoqata dhe organizata qytetare.

Ndotja e ajrit, stërm bush klinikat e fëmijëve



Është rritur numri i fëmijëve me sëmundje respiratore dhe viruse stomaku. Një nga arsytet për probleme të tilla supozohet të jetë ndotja e ajrit. Mjekët shpjegojnë se në ditët e fundit në klinikë vijnë çdo ditë nga 150 fëmijë, dhe shumica e tyre kërkojnë ndihmë për shkak të infeksioneve respiratore dhe viruseve në stomak, raporton Alsat-M.

“Unë vetëm mund të them se klinika është e mbushur deri në shtratin e fundit, ka fëmijë të cilët janë duke pritur tani në qendrën emergjente për tu pranuar, qofshin me viruse stomaku apo infeksione respiratore, ose sëmundje tjera klinika dhe korridoret janë të mbushura siç mund të shihni”, deklaroi Maja Ivanovska, mjeke në Klinikën e fëmijëve.

Fëmijëve u shkaktojnë probleme edhe viruset e stomakut të cilat edhe se nuk janë tipike për këtë kohë të vitit janë të pranishme për shkak të motit jo-stabil.




FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Skandal: Klinika ka “marrëveshje 2014-vjeçare” me Fondin e Shëndetësisë



Klinika Universitare e Syve në Shkup ka bërë një “Marrëveshje 2014-vjeçare” me Fondin e Shëndetësisë. Të paktën kështu shkruhet në këtë fletushkë të vendosur në korridorin e spitalit, drejtori i së cilës është shqiptar. Në afërsi të saj, një mori tjetër e njoftimeve që është tentuar të shkruhen në shqip, por rezultati i tyre nuk është as shqip e as maqedonisht, njofton TV SHENJA.

As njoftimet për pacientët nuk duken më mirë. Për shembull fletëpagesës së pensionit i thuhet “cek” ndërsa i gjithë njoftimi duket të jetë shkruar nga dikush që ka përdorur programe për përkthim, pa pasur njohuri elementare për gjuhën shqipe. Herë pas here njoftimi ka kuptim, herë pas here ka ndonjë fjalë në gjuhën letrare, por më tragjikja është që ka edhe fjalë popullore si “krejt kontrolat”.

Gjuhëtarët kritikojnë këto fletushka por edhe gjithë gjendjen e mjerueshme me shtrembërimin e gjuhës shqipe të ndikuar nga maqedonishtja. Sipas Ajtene Qamilit, lëshime të tilla janë të pafalshme, sidomos kur me një institucion publik të tillë drejton kuadër shqiptar.

Qamili sugjeron që për të evituar gabimet duhet që të të angazhohen gjuhëtarë në çdo